



Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly




Lidhja Demokratike e Kosovës

Për: z. Ymer Fejzullahu, Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Cc: z. Albin Kurti, kryeministër i Republikës së Kosovës; znj. Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë; z. Hekuran Murati, ministër i Financave dhe Transfereve

Nga: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës

Lënda:  Komete në raportin konsultativ të ZRRE “Shqyrtimi i Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërive të shërbyer nën FSHU” publikuar më 17.01.2022

Datë: 31.01.2022

I nderuari z. Fejzullahu,

Në cilësinë e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, po ju drejtohem me këtë letër, për të dhënë komentet tona në raportin konsultativ “Shqyrtimi i Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërive të shërbyer nën FSHU” të hartuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

1. Tarifat e propozuara janë të papërballeshme, andaj propozojmë të mbeten të pandryshuara deri në fund të këtij viti;
2. Për të tejkaluar krizën, propozojmë që Qeveria të heqë TVSH-në për energjinë elektrike për të gjithë konsumatorët;
3. Qeveria gjithashtu të subvencionojë energjinë për të gjithë konsumatorët njëjtë, në mënyrë që të mbajë tarifën ashtu siç janë deri në fund të këtij viti;
4. ZRRE të hapë diskutimet në fillim të qershorit me të gjitha palët e interesit për shqyrtimin e tarifave, zbatimin e cilave do të fillojë prej datës 1 janar 2023;
5. Qeveria të angazhohet për themelimin e “Fondit për konsumatorët në nevojë” ashtu siç e obligon Ligji për Energjinë.

6. Të ofrohet sa më parë alternativa afatgjata të furnizimit me energji të qëndrueshme dhe të përballueshme . Në këtë drejtim, të ndërpriten vonesat e paarsyeshme dhe të dëmshme të Qeverisë në lidhje me gazifikimin e Kosovës, një projekt që shtetet e rajonit e kanë nisur tashmë . E ardhmja e energjisë në Kosovë është e pastër; por Kosova sikurse Evropa, po kalon në disa dekada të tranzicionit energjetik. Në këtë tranzicion ne duhet të sillemi me përgjegjësi ndaj sigurimit dhe përballimit të energjisë paralelisht. Qeveria poashtu duhet të përshpejtojë dhënien e lejeve për nisjen masive të investimeve private drejt sektorit të energjisë solare.
7. Përfundimisht, propozimi aktual i ZRRE-së, duke i trajtuar qytetarët në mënyrë të pa barabartë; ku një kategori e subvencionohet 100% tarifa, ndërsa tjerave jo, është akt diskriminues dhe në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht parimit të barazisë së qytetarëve para ligjit.

Arsyetim

Duke marrë parasysh se gjendja pandemike ka rënduar, në disa raste edhe ka rrënuar jetën e qytetarëve të vendit tonë; duke marrë parasysh që inflacioni në shumicën e artikujve bazë që bëjnë shportën e konsumatorit ka arritur nivelet deri në 30%; duke marrë parasysh që nuk ka pasur ngritje të pagave as në sektorin publik as në atë privat; duke marrë parasysh që paga minimale nuk ka lëvizur që më shumë se një dekadë konsiderojmë se Zyra e Rregullatorit të Energjisë së bashku me Qeverinë duhet të bëjë më shumë dhe të gjejnë zgjidhje më të mira, më kreative dhe të mos e rëndojnë edhe më tepër koston e jetës së qytetarëve duke shtrenjtuar energjinë elektrike sipas propozimit publik.

Ngritja e tarifave duke marrë parasysh edhe subvencionimin e Qeverisë është e papërballueshme dhe njëherësh është shumë diskriminuese për qytetarët e vendit. Për të shmangur çfarëdoj diskriminimi, për ta bërë këtë krizë lehtë të tejkalueshme për të gjithë, është e mundshme që të bëhet rritje lineare e tarifave në vlerë përafërsisht prej 6.7% POR ne insistojmë që pas kalkulimeve të ZRRE-së që duhet të bëhen me të përfunduar stina e dimrit Qeveria jonë e cila duhet të paguajë 43 milionë euro për katër komunat veriore (për vitin 2021) me pak angazhim mund të gjejë edhe 21 milionë euro shtesë nëse ka nevojë dhe t'i lë tarifat ashtu siç janë sot deri në fund të këtij viti.

Andaj, duke pasur për bazë të gjithë ato që u thanë më lartë, propozoj Qeverisë ta heqë TVSH-në për energjinë elektrike për vitin 2022, të shtojë subvencionet, nëse ka nevojë pasi të bëhen llogaritjet e reja të ZRRE-së, të cilat duhet të reflektojnë rënien e kërkesës për energji pasi të kalojë stina e dimrit.

Propozimi me llogaritje të përafërta:

Në raportin konsultativ të ZRRE-së, seksioni 6.1, faqe 21 thuhet:

“6.1 Përcaktimi i tarifës në nivel që reflekton koston e sistemit”. Siç u tha më lart, niveli i të hyrave maksimale të lejuara për të mbuluar kostot e sistemit, dhe që ndër lidhet me kostot e larta të importit, është vlerësuar në një raport të ndarë të ZRRE-së dhe arrin nivelin prej €446.7 milionë.

Niveli ekzistues i tarifave, aplikuar sipas strukturës ekzistuese tarifore, mund të gjenerojnë €314 milionë. Mbulimi i ndryshimit në mes të kostove të nevojshme të sistemit dhe atyre që mund të gjenerohen nga tarifrat ekzistuese, pra ndryshimit prej €132.7 milionë, do të nënkuptonte rritje lineare të tarifave në vlerë prej 42%."

Pra, sipas ZRRE-se duhet të akomodohen 132 milionë euro (të hyrat shtesë të lejuara nga ZRRE-ja) në tarifrat e reja dhe kjo do të nënkuptonte rritje lineare të tarifave në vlerë prej 42%. Pasi Qeveria ka vënë në dispozicion 75 milionë euro për subvencionim të energjisë, sikur kjo të përdoret për të gjithë konsumatorët pa dallim, atëherë nuk ka nevojë për rritje lineare të tarifave 42% por një rritje lineare 18% për të mbuluar 57 milionë euro ($132 - 75 = 57$ milionë euro). Nëse Qeveria e heqë TVSH-në për energjinë elektrike që është 8%, 8% e 446 milionë eurove është 35 milionë euro, atëherë shuma për t'i mbuluar tarifrat e reja do të jetë $57 - 35 = 21$ milionë euro, e cila do të mund të mbulohet me rritje lineare të tarifave në vlerë prej 6.7% - jo 107% siç keni propozuar; të bëhet ngritja e tarifës së lartë nga 6.75 cent/kw në 14 cent/kw dhe asaj të ultë nga 2,89 cent/kw në 7 cent/kw për ekonomitë familjare që shpenzojnë mbi 600 kw POR ne insistojmë që pas kalkulimeve të ZRRE-së që duhet të bëhen me të përfunduar stina e dimrit Qeveria jonë e cila duhet të paguajë 43 milionë euro për katër komunat veriore (për vitin 2021), me pak angazhim mund të gjejë edhe 21 milionë euro shtesë nëse ka nevojë dhe t'i lë tarifrat ashtu siç janë sot deri në fund të këtij viti.

Me respekt,